



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 20.06.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Arbërie Nagavci, Abdyl Salihu, Mufera Shinik, Albulena Balaj – Halimaj dhe Verica Çeraniq.

Munguan: Fidan Rekalju, Valentina Bunjaku – Rexhepi dhe Driton Çausi.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të KDI-së dhe mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtim i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtim i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë

Ismajl Kurteshi tha se komisioni ka punuar një kohë të gjatë në këtë projektligj, anëtarëve të komisionit iu është dhënë edhe një mundësi e shqyrtimit në mënyrë që të mos ketë ndonjë lëshim para se të dërgohet te komisionet e përhershme për shqyrtim. Ai ftoi të gjithë deputetët për diskutim lidhur me ndonjë propozim apo vërejtje në ndonjë nen të caktuar.

Nezir Çoçaj tha se në takim do të duhej të ishin të pranishëm edhe ndonjëri nga përfaqësuesit e ministrisë, në mënyrë që të evitohen paqartësitë rreth definicioneve përfundimtare, por edhe sepse është edhe në interes të tyre përmbyllja e këtij projektligji.

Teuta Haxhiu tha se dilema e saj qëndron te neni 9, në mënyrë specifike tek emërtimi i inkubatorit afarist teknologjik si institucione. Ajo tha që askush nuk ka sqaruar bindshëm se pse duhet të emërtohen si institucione dhe shtoi që duhet Komisioni të punojë së bashku për të gjetur një emërtim më të përshtatshëm.

Verica Çeraniq tha se për shkak të marrjes me vonesë të projektligjit të përkthyer në gjuhën serbe, nuk mund të afrojmë ndonjë koment lidhur me ndryshimet potenciale në këtë projektligj.

Ismajl Kurteshi tha se ky projektligj është shqyrtuar shumë herë dhe në shumë takime që janë mbajtur, kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të MASHT-it që kanë dhënë të gjitha sugjerimet dhe propozimet e tyre dhe është arritur në përfundim me informatat e të gjitha burimeve që janë në dispozicion. Ai mbështeti qëndrimin e Teutës rreth inkubatorit për emërtimin institucion apo diçka tjetër, mirëpo që sipas përfaqësuesve të MASHT-it nuk ka ndonjë emërtim më të përshtatshëm se sa institucion. Ai gjithashtu tha që mbledhjen e kaluar kishte propozuar që të quhet trupë, e jo institucion, mirëpo që nuk kishte gjetur mbështetjen e anëtarëve të komisionit. Ismajl Kurteshi tha që meqë projektligji ka ardhur në fund, ajo se për çfarë ka hapësirë diskutimi është vetëm a të miratohet projektligji pa praninë e përfaqësuesve të MASHT-it apo mund të votohet edhe pa praninë e tyre.

Teuta Haxhiu tha se Ministria ka dhënë kontributin e tyre në mbledhjet e kaluara dhe nuk kanë pasur ndonjë mendim tjetër sa i përket nenit 9. Ajo tha se për këtë dilemë dhe për çdo dilemë tjetër, mund të vendosë Kuvendi meqenëse edhe i zotëron këto kompetenca. Ajo tha se duhet të përfundohet ky projektligj dhe të fillohet të punohet për projektligjet e tjera.

Nezir Cocaj tha se ai mbështet qëndrimin se inkubatori afarist teknologjik është institucion. Ai tha se çdo dokument / strategji që hartohen nga organizatat e BE-së duhet të përfillen, si dhe që

këto janë më shumë definicione fizike dhe gjeografike sesa që kanë të bëjnë me hulumtime shkencore.

Ismajl Kurteshi tha që edhe pse natyra e këtij projektligji nuk është shumë e mishëruar me natyrën e Komisionit Parlamentar për Arsim, kemi pasur mbështetjen e MASHT-it dhe angazhimin e deputetëve, mirëpo që ka munguar përkrahja e institucioneve të tjera përkundër ftesave dhe shkresave. Ai tha që shpreson që ky ligj të i shërbejë edhe qëllimeve për të cilat është hartuar dhe që Komisioni është i hapur edhe për kritika.

Anëtarët e Komisionit propozuan amendamentet në vijim:

Amendamenti 1

Neni 2, nënparagrafi 1.5, riformulohet si vijon:

1.5. Inovacioni - veprimtari që ndërmerret me qëllim të krijimit të prodhimeve, teknologjive, proceseve dhe shërbimeve apo dijeve të reja, duke i zëvendësuar apo avancuar të vjetrat, me qëllim të përparimit të përgjithshëm shoqëror për nevojat e tregut.

Amendamenti 2

Neni 2, nënparagrafi 1.6, riformulohet si vijon:

1.6. Produkti inovativ- aplikim i një produkti të ri ose të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, por që nuk është një ndryshim i natyrës estetike ose vetëm shitje e produkteve të shpikura, prodhuara ose zhvilluara nga një person fizik ose juridik.

Amendamenti 3

Neni 3, riformulohet si vijon:

Zbulimet apo shpikjet shkencore të cilat shprien deri të një prodhim i ri, proces i ri apo teknologji e re me karakteristika unike, të krijuara, duke u bazuar në të arriturat individuale apo ekipore e shkencore.

Amendamenti 4

Neni 4, nënparagrafi 1.6, pas fjalës “Personat” fshihet fjala “tjerë”.

Amendamenti 5

Neni 4, paragrafi 2, pas fjalës “shkencor” shtohet teksti “sipas legjislacionit në fuqi”.

Amendamenti 6

Neni 5, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. MASHT-i dhe ministritë e linjës janë përgjegjëse për motivimin dhe nxitjen e zhvillimit të veprimtarisë inovative.

Amendamenti 7

Neni 5, nënparagrafi 3.3, riformulohet si vijon:

3.3. Të grumbullimit dhe afrimit të informatave për institucionet përgjegjëse mbi veprimtarinë inovative shkencore në vend;

Amendamenti 8

Neni 5, paragrafi 4, riformulohet si vijon:

4. Qeveria me akt nënligjor përcakton detyrat specifike për secilën ministri në fushën e inovacionit shkencor.

Amendamenti 9

Neni 6, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

2. Këshilli përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë me rezultate të dëshmuara ndërkombëtare në shkencë, inovacion shkencor dhe biznes. Anëtarët e Këshillit propozohen nga:

- 1.1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- 1.2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- 1.3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- 1.4. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë;
- 1.5. Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (nga diaspora);
- 1.6. Oda Ekonomike e Kosovës;
- 1.7. Përfaqësues i organizatave që merren me zhvillim, hulumtim dhe inovacion.

Amendamenti 10

Neni 6, paragrafi 3, riformulohet si vijon:

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit:

Amendamenti 11

Neni 6, nënparagrafi 3.2, riformulohet si vijon:

3.2. Përzgjedh praktikat e mira ndërkombëtare dhe vendore dhe ia propozon Qeverisë që t'i aplikojë.

Amendamenti 12

Neni 6, nënparagrafi 3.3 fshihet.

Amendamenti 13

Neni 6, nënparagrafët 3.4 dhe 3.5 bëhen paragraf 4 dhe 5, ndërsa renditja e paragrafit në vijim bëhet sipas radhës.

Amendamenti 14

Neni 7, paragrafi 3, pas fjalës “nënligjor” shtohet teksti “të propozuar nga ministrinë e linjës dhe të miratuar nga Qeveria”

Amendamenti 15

Neni 8, paragrafi 5, pas fjalës “nënligjor” shtohet teksti “të nxjerrë nga MASHT”.

Amendamenti 16

Neni 9, riformulohet si vijon:

1. Institucionet mbështetëse për afrimin e ndihmës infrastrukturore në fushën e inovacionit shkencor janë:
 - 1.1. Inkubatori afarist-teknologjik;
 - 1.2. Parku shkencor-teknologjik;
 - 1.3. Akseleratorët (përshpejtuesit) e inovacionit shkencor;

Amendamenti 17

Pas nenit 9, shtohen dy nene të reja, ndërsa radhitja e neneve në vazhdim bëhet sipas radhës:

Inkubatori afarist-teknologjik

1. Inkubatori afarist – teknologjik është institucion afarist i krijuar me qëllim të vënies në dispozicion të hapësirës punuese, afrimit të shërbimeve administrative, teknike dhe të tjera, ndërmarrjeve të sapokrijuara apo institucioneve që kryejnë veprimtari të inovacionit shkencor në vitin e parë të themelimit të tyre.
2. Licencimi, regjistrimi dhe funksionimi i inkubatorit afarist-teknologjik rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MASHT.

Parku shkencor-teknologjik

1. Parku shkencor-teknologjik u afron shërbime profesionale dhe infrastrukturore universiteteve, instituteve kërkimor-shkencore dhe institucioneve të tjera që merren me inovacione shkencore dhe që i takojnë një fushe të caktuar të shkencës.
2. Shërbimet e parkut kanë për qëllim krijimin e lidhjeve në mes të institucioneve kërkimore-shkencore për aplikimin e teknologjive, krijimin e prodhimeve dhe shërbimeve të reja, si dhe plasimin e tyre në treg.
3. Të gjitha institucionet që përdorin këto shërbime apo janë të lidhur me parkun shkencor-teknologjik gëzojnë statusin e anëtarit të parkut shkencor-teknologjik.
4. Ky status u mundëson anëtarëve të parkut shfrytëzimin e kushteve hapësinore dhe infrastrukturore, kushteve të punës dhe shërbimeve të tjera, me qëllim të ngritjes së nivelit dhe të cilësisë së punës kërkimore-shkencore, zhvillimore, inovative dhe prodhuese.
5. Ofrimi i shërbimeve dhe shfrytëzimi i tyre, rregullohet me marrëveshje ndërmjet palëve.
6. Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të parkut shkencor-teknologjik rregullohen me kontratë.

Amendamenti 18

Në tërë tekstin e projektligjit fjalët ”teknologjisë dhe dijes” zëvendësohen me fjalët ”dijes dhe teknologjisë” varësisht nga kontesti i fjalisë.

Amendamenti 19

Neni 11, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 bëhen paragraf 2 dhe 3.

Amendamenti 20

Neni 14, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Pronari i një teknologjie ose poseduesi i dijes së caktuar ka të drejtën për ta transferuar të drejtën e përdorimit të teknologjisë që e posedon.

Amendamenti 21

Paragrafin 2, riformulohet si vijon:

2. Çdo palë që ka lejen e pronarit të një teknologjie, ose lejen e autorit të dijes së caktuar, për transfer duhet ta ketë të drejtën e përdorimit sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Amendamenti 22

Neni 16, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Kufizohet transferimi i një teknologjie që nuk është në përputhje me:

Amendamenti 23

Neni 16, nënparagrafi 1.5, fshihet fjala “(nënshkruar)”

Amendamenti 24

Neni 19, nënparagrafi 1.8, riformulohet dhe bëhet paragraf 2, si vijon:

2. Kushtet për regjistrimin e mekanizmave të parapara në nënparagrafët 1.3; 1.4; 1.5 dhe 1.6 të këtij neni rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.

Amendamenti 25

Neni 20, riformulohet si vijon:

Qeveria dhe Ministria brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerrin aktet nënligjore të parapara me këtë ligj.

Anëtarët e Komisionit pas shqyrtimit të projektligjit, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) abstenim, komisioni procedon raportin me amendamente te komisionet e përhershme për shqyrtim.

3. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi ngriti çështjen e punës së grupeve punuese sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe kërkoi angazhim të shtuar të anëtarëve të grupeve punuese. Po ashtu propozoi që Komisioni javën e ardhshme më 26 qershor 2018 të organizojë dëgjim publik lidhur me Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

Teuta Haxhiu tha se si kryesuese e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Sponsorizime gjatë kësaj jave do të ketë një takim. U pajtua lidhur me organizimin e dëgjimit publik për projektligjin për mësimdhënësit e viteve të 90-ta. Po ashtu propozoi që komisioni të marrë pjesë në njërin nga mbledhjet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Akreditimit.

Arbërie Nagavci tha se pret ftesën për të marrë pjesë në takimet e grupit punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve. Po ashtu ngriti shqetësimin e saj për sa i përket cilësisë së dobët të projektligjeve që po procedohen nga MASHT.

Nezir Çoçaj tha se pajtohet me propozimin për organizimin e dëgjimit publik për projektligjin për mësimdhënësit e viteve të 90-ta, si dhe propozoi që në ditën në vijim të organizohet një debat parlamentar për gjendjen në Arsimin e lartë dhe shkeljet e vazhdueshme që po i bënë MASHT.

Albulena Balaj-Halimaj theksoi se nuk pajtohet me deklaratimet e parafolësit lidhur me pretendimet për shkeljet që po i bënë MASHT. Ajo tha se veprimet e ministrit janë në kuadër të obligimeve dhe kompetencave që i ka dhe nuk ka asnjë ndërhyrje politike siç po pretendohet. Sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve tha se do ta japë kontributin e saj në grupet punuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi